



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. GJ/1168 21/09/2020

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 10.09.2020, mori:

VENDIM

Dr.sc. Dukagjin Leka, zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor i Asocuar** për lëndët: E drejta ndërkombëtare private, E drejta ndërkombëtare publike, E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, E drejta Unionit Evropian dhe E drejta ndërkombëtare humanitare, në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 156 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit. Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: E drejta ndërkombëtare private, E drejta ndërkombëtare publike, E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, E drejta Unionit Evropian dhe E drejta ndërkombëtare humanitare, në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof.Ass.Dr. Dukagjin Leka, i plotëson kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen akademike Profesor i Asocuar për lëndët e sipërpërmendura. Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Dr.sc. Dukagjin Leka, të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor i Asocuar.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe të Universitetit drejtuar Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit të Universitetit.

REKTORI

Prof/Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave